



KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Numri i Shërbimit Parapremt/Precedenti Procedurë/Reference	30-04/2021	Numri i Kështjës Procedurë	1
Organ Objektive Organ Çështjesh City/Objekt	2154/2021	Numri i Kështjës Procedurë	1/190



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.212/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit numër A.nr.523/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.836/2018 të datës 17.12.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Rexhep Krasniqi", Nr.225, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër të protokollit 14-070/01-265334/18 të datës 29.11.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.836/2018 e datës 17.12.2018 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohen Vendimi me numër 14-070/01-265334/18 i datës 29.11.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës dhe Vendimi i datës 15.10.2018 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës i protokolluar me datë 17.10.2018 me numër prot. 2202.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës, sipas Akt Emërimit të datës 30.07.2013 me numër 01-031-131378, me të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga marrëdhënia e punës si dhe t'i bëjë kompensimin e të gjitha pagave prej momentit të largimit deri në ditën e kthimit të tij në vendin e punës.



V. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditorë nga dita e pranimit të tij.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas akt emërimit të datës 30.07.2013 me numër 01-031-131378 i sistemuar në vendin e punës "Drejtorë i Qendrës për Punë Sociale", në Komunën e Prishtinës. Ndaj ankuesit Kryetari i Komunës së Prishtinës ne datë 24.09.2018 me numër të protokollit 14-116/01-231880/18 ka raportuar për shkelje të supozuar disiplinore e kryer nga ankuesi me arsyetim se: *"Bazuar në informacionet e pranuar me e-mail nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor, z. me datë 20.09.2018, kërkoi që të fillohet me procedurën disiplinore ndaj z. për supozimin e deklarimit të rrejshëm"*.

Komisioni Disiplinor me datë 15.10.2018 nxjerr vendimin i cili është protokolluar me datë 17.10.2018 me numër 2202, me të cilin vendim ankuesit i shqiptohet masa disiplinore "ndërrprerje e marrëdhënias e punës", me arsyetimin se ankuesi me rastin e raportimit të shkeljes disiplinore numër 14-116/01-0199713/18 të datës 15.08.2018 ka bërë deklaram të rrejshëm lidhur me raportimin e shkeljes së supozuar nga

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.10.2018 me numër 2202, me datë 05.11.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 14-070/01-165334/18 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës me datë 29.11.2018 nxjerr vendimin me numër të protokollit 14-070/01-265334/18 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, me datë 17.12.2018 parashtron ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 7703/2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës më datë 18/12/2018 me Nr.prot.7740, Komuna e Prishtinës më datë 27.12.2018 Nr.prot.8012/2018 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020,ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë

14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 07.02.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke inicuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.523/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.02.2019, duke kthyer në KPMSHCK-lëndën për vendosje në lidhje me ankesën të datës 17.12.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me këtë lëndë ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit e datës 17.12.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-070/01-265334/18 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës datës 29.11.2018; Formularin e datës 05.11.2018 të parashtrimit të ankesës, Ankesën e ankuesit e datës 05.11.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës; E-mailin e datës 17.10.2018 dërguar nga S. për Vendimin e datës 17.10.2018 të Komisionit Disiplinor me numër 2202; Njoftimi i datës 24.09.2018 me numër Reference:14-11/01-231880/18; Formularin për raportimin e shkeljes disiplinore të datës 24.09.2018; Formularin e datës 18.10.2018 për parashtrim të ankesës apo kërkesës; Formularin për raportimin e shkeljes disiplinore të datës 17.10.2018; Njoftimin lidhur me ankesën nr.14-70/01-0252893/18/1 të datës 16.10.2018; Vendimin e datës 13.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës për Formularin për raportimin e shkeljes disiplinore të datës 14.08.2018 me numër:05-55/441; Formularin e datës 15.08.2018 për parashtrim të ankesës apo kërkesës; Vendimin e UD/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë me numër protokoli:05-672/2 të datës 02.02.2018; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 05.07.2018; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 13.03.2018; Vendimin e UD/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë me numër protokoli:118/XII/2016 të datës 21.12.2016; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 05.07.2017; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 27.06.2017; Vendimin e UD/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë me numër protokoli:178/IX/2017 të datës 22.09.2017; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 13.03.2018; E-mailin e datës 17.10.2017 dërguar nga Çertifikatën e pjesëmarrjes së ankuesit lëshuar nga OJQ Labyrinth të datës 07.03.2018; Letërefrencën nga Jessica Rhys-Griffith e datës 23.08.2010; Letër rekomandimin e datë 25.12.2015; Shkresën e datës 26.01.2017 me numër refernce: IGJK/16/2017; Çertifikatën e pjesëmarrjes së datës 16.12.2014; Çertifikatën e ankuesit të

lëshuar nga Terre des hommes; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kopjen e ID-së së punës së ankuesit; Çertifikatën e ankuesit të lëshuar nga GIZ; Letër referencën e datës 09.08.2018; Shkresën e datës 20.01.2015 me numër reference: IGJK/11/2015; Çertifikatën e ankuesit të lëshuar nga Zas Trade të datës 14.09.2015; Letër rekomandimin e datës 26.04.2007; Çertifikatën e lëshuar nga Revieve të datës 07.02.2014; Letër rekomandimin e lëshuar nga Friedrich Ebert Stiftung-Zyra në Prishtinë për ankuesin; Shkresën për elaborimin e rastit nga ankuesi në përmbajtje nga faqe 64 deri të faqe 86 sipas renditjes së protokollit numër 7703/2018 të datës 17.12.2018; Akt Emërimit e ankuesit datës 30.07.2013 me numër: 01-031-131378; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 22.09.2017; Aprovimi nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil i datës 09.12.2013; Vërtetimin mbi përvojën e punës së ankuesit i datës 05.11.2018; Përgjigjen në ankesë të datës 27.12.2018 me numër protokoll:8012/2018; E-mailin e datës 20.09.2019 dërguar në _____ për Kryetarin e Komunës _____ për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës të datës 10.10.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës të datës 29.11.2018; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 13.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 13.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 12.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 13.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 13.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 12.09.2018 i marrjes në pyetje të _____ Njoftimi i datës 07.02.2019 me numër protokoll:669/2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Aktgjykimin numër A.nr.523/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Vebi Mujku është, *e bazuar, SEPSE*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se është shkelur Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka pas konstatim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe është shkelur Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni disiplinor i Komunës së Prishtinës me nxjerrjen e vendimit të datës 15.10.2018 i cili është protokolluar me datë 17.10.2018 me numër:2202, ankuesit _____ i shqiptohet masa disiplinore "*ndërprerje e marrëdhënia e punës*" në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" sipas vendimit të datës 15.10.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës i protokolluar me datë 17.10.2018 me numër prot. 2202, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: „1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar” gjithashtu nenin 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: "Nëpunësi civil shikarohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me këtë ligj." si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: "1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shikuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor" si dhe "2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor " si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 i cili përcaktojnë se: "dështimi i deklarimit ose dhënia e deklaratës të rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit", si dhe neni 8 paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: 1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension", andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" është masa më e rëndë që shqiptohet në Shërbimin Civil përkundër që shkelja e apostrofuar në vendim të komisionit disiplinorë nuk është arsyetuar në asnjë mënyrë me argumente të mjaftueshme ligjore .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil", ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të shërbimit civil sepse nëpunësi civil mbi bazën e shqyrtimit dhe analizimit të provave që janë bërë nga kolegji është konstatuar se nga autoriteti punëdhënës në këtë rastë komuna e Prishtinës përmes kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, komisioni disiplinor dhe ai i ankesave nuk kanë arrit të argumentojnë përmes provave konkrete se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, për të i shqiptuar masën më të rëndë të ndërprerjes së marrëdhënies së Punës, dhe kjo mund të konfirmohet lehtë nëse shikohet me kujdesë formulari i raportimit të shkeljes disiplinore i nënshkruar nga inicuesi i kësaj procedure i datës 21/09/2018,në të cilin dokumente konstatohet fakti se nuk është argumentuar përmes provave konkrete që ankuesi ka bërë shkelje të rëndë ashtu që komisioni të i shqiptoj masën më të rëndë disiplinore,pa saktësuar dispozitat konkrete ligjore që argumentojnë kërkesën dhe pa potencuar ndonjë fakt të vetëm në kërkesë që e bënë të qëndrueshëm pretendimin për shkelje të supozuar dhe që argumenton shqiptimin e masës më të rëndë.



Kolegji vlerëson se Kryetari i Komunës së Prishtinës në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk ka identifikuar dhe konstatuar se për cilat shkelje të parimeve dhe rregullave të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë është përgjegjës nëpunësi civil, gjegjësisht cilat janë veprimet apo mosveprimet e ankuesit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të cilat janë cilësuar si shkelje të rëndë-serioze, dhe me cilat dispozita janë përcaktuar ato shkelje.

Ndërsa në lidhje me pretendimin sa i përket çështjes së iniciimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit sipas raportit të shkeljes Kolegji konstaton se është i bazuar sepse iniciimi i procedurës disiplinore është bërë më datë 21/09/2019 sipas njoftimit të datës 20/09/2018 nga kryesuesi i komisionit disiplinorë, ndërsa seanca në lidhje me këtë rast është mbajtur më datë 10/10/2018. Andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë jashtë afatit të përcaktuar me nenin 12 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinorë në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy (2) ditë pune do ta paraqes rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë së personelit.*

Poashtu kolegji me rastin e shqyrtimit të pretendimit të ankuesit se është shkelur paragrafi 1,2 dhe 3 i nenit 11 të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinore në Shërbimin Civil, konstaton se është i bazuar ky pretendim nga se me rastin e iniciimit të procedurës disiplinore nuk është vepruar konformë këtyre dispozitave ligjore dhe kjo lehtë mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës nga se mungojnë veprimet konkrete të bazuara në këto dispozita.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë analizimit të vendimit me numër:2202 të datës 15.10.2018 të Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës në pjesën e arsyetimit të vendimit në faqen 3 (tre) ku theksohet se, citoj *për shkakë të shkeljes disiplinore, nga neni 6, paragrafi 1.12 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës*, si dhe analizimit të shkresës së dërguar përmes emailit të datës 20.09.2018 nga kryetari i Komisionit Disiplinor te Kryetari i Komunës me rastin e kërimit të iniciimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ka deklaruar se ankuesi ka paraqitur rastin në Komision Disiplinor për z. [] zyrtar për shërbime sociale i cili është i sistemuar në Njësinë e Kodrës së Trimave, dhe me këtë rast Kolegji ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me datë 13.09.2018 ka nxjerr vendim me të cilin i shqiptohet masë disiplinore nëpunësit civil *"ndalim gradimi deri në 1 (një vit)"*, bazuar në raportin e iniciimit të procedurës disiplinore të datës 14.08.2018, me arsyetimin se z. [] gjatë mbledhjes të cilën e kanë pas e ka fyer z. [] dhe konstatimin se z. [] nuk ka pasur për qëllim të sulmojë fizikisht ankuesin, andaj mbi bazën e kësaj kryetari i Komisioni Disiplinor ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se ka dhënë deklaratë të rrejshme për konfliktin e interesit.



Kolegji me qëllim të vendosje meritore ka analizuar dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 i cili përcakton se: *"dështimi i deklaramit ose dhënia e deklaratës të rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit"* si dhe dispozitat e Ligjit Nr.06/11- për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik neni 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 përcakton se: *"Interes privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, si dhe neni 6 i të njëjtit ligj përcakton se: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethuanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, të cilat i qartësojnë se pretendimet e Kryetarit të Komisionit Disiplinor mbi bazën e të cilave është iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, s'kanë të bëjnë aspak me dhënien e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit, dhe se veprimi i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës me ç' rast iniciuesit të procedurës disiplinore z. i ka shqiptuar masën më të rëndë disiplinore *"ndërprerje e marrëdhënies së punës"* ndërsa, nëpunësit civil i cili ka qenë subjekt i një procedurë disiplinore edhe pse është konfirmuar se i njëjti e ka fyer rëndë z. i shqiptohet masë shumë më e lehtë disiplinore *"ndalim gradimi deri në 1 (një) vit"* si i tillë ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i cili përcakton se: *"Jo-diskriminimi - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal"*, si dhe nenin 42 paragrafin 2 të të njëjtit ligj i cili përcakton se: *"Organi i punësimit siguron kushte me të cilat mbrohet integriteti fizik dhe moral i nëpunësit civil"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër: 2202 të datës 15.10.2018 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndërprerje e marrëdhënies së punës"* e cila vlerësohet si masa më e rëndë që shqiptohet në shërbimin civil ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor"*, pasi që Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk e ka evidentuar apo saktësuar se cili është dëmi që ankuesi i ka shkaktuar institucionit si dhe masa disiplinore e shqiptuar nuk është në proporcion me shkeljen e supozuar, duke pasur parasysh faktin se në bazë të provave të ofruara nga institucioni punëdhënës përmes shkresës së datës 27.12.2018 me numër protokoll:8012/2018 nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë se ankuesi më herët ka pasur ndonjë vërejtje apo masë të shqiptuar disiplinore, po ashtu masa disiplinore *"ndërprerja e marrëdhënies së punës"* nuk është masa e vetme që mundet apo duhet t'i shqiptohet nëpunësit civil nga Komisioni Disiplinor pasi që edhe dispozitat e Rregullores



Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 8 paragrafi 2 i cili përcakton se: *"Në përcaktimin e masave adekuate, komisioni duhet të ketë parasysh se qëllimi i procedurës disiplinore është të përmirësojë dhe inkurajojë sjellje të mirë dhe të dënojë sjelljen jo të mirë"*, nga rrjedh se komisioni disiplinor në rastin konkret i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore më të rëndë në shërbimin civil, qëllimi i së cilës nuk ka qenë inkurajimi apo përmirësimi i sjelljes.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës dhe çështjeve të evidentuara më lart në këtë vendim, ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës më numër: 2202 i datës 15.10.2018 është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i cili përcakton se: *"Akti administrativ i shkruar përmban pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin)"* nenin 48 paragrafi 1 paragrafi 1.4 i cili përcakton se: *"1.Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret"*, nenin 48 paragrafi 2 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, andaj si i tillë Vendimi i Komisionit Disiplinor është i paligjshëm dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik siç e përcaktojnë dispozitat Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4; 1.5 dhe 1.6 i cili përcakton se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6 është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme,"*, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit se është shkelur Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, se ka pas konstatim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe është shkelur Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, janë të plotësisht qëndrueshme dhe të bazuara.

Ndërsa nga Komuna e Prishtinës me rastin e marrjes së përgjigjes në ankesë të datës 27/12/2018 me nr.prot.8012/2018 nuk kemi marrë ndonjë përgjigje që argumenton pretendimin e tyre në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore përveç që na kanë kthyer përgjigje duke na bashkangjitur disa prova, poashtu përgjigja është dërguar jashtë afatit ligjor të paraparë me ligjin Nr.06/L-048 për KPMSHCK-në, pasi shkresa nga komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë është pranuar më datë 19/12/2019, që konfirmohet me flet kthesë, ndërsa në nenin 17 paragrafi 3 të këtij neni shprehimisht parashihet: *"Organi i punësimit është i obliguar që brenda afatit prej pesë (5) ditësh pune, nga dita e pranimit të kërkesës për përgjigje në ankesë, të kthejë përgjigje dhe të ofrojë të gjitha dëshmitë që i kërkon Këshilli"*. Andaj kolegji edhe mbi këtë bazë konstaton se pretendimi sa i përket ankesës është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se Vendimit të Komisionit Disiplinor i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase vendimi përkatësisht arsyetimi i

vendimit duhet që të ketë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilin është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret. Në arsyetimin e vendimit Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk kanë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që e kanë kushtëzuar shqiptimin e masës disiplinore gjegjësisht ndërprerjen e marrëdhënies së punës ankuesit. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Komisioni Disiplinor duke mos saktësuar shkëlqet dhe përgjegjësitë e ankuesit me veprimet dhe mosveprimet e tija ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 51, 52, 55, 64 dhe 65 të Ligjit Nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, me çka Kolegji konstaton se edhe masa e shqiptuar është në kundërshtim me nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 nën-nëparagrafin 1.2.4 të Ligjit Nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 14-070/01-265334/18 të datës 29.11.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj mbi bazë të provave të administruara, të dorëzuara nga palët në procedurë kolegji konstaton se ekziston baza ligjore për aprovimin e ankesës së ankuesit ashtu që komuna e Prishtinës është e obliguar që të zbatojë vendimin e Këshillit duke e kthyer në vend të punës ankuesin Vebi Mujku sipas Akt Emërimit të datës 30.07.2013 me numër 01-031-131378, dhe poashtu të kompensoj të ardhurat personale nga momenti i largimit deri në momentin e kthimit në vend të punës sipas këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.212/2021, datë 30/04/2021

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

